Thirrja për propozimin e projekteve
Investimi në hotspotet e biodiversitetit në Pellgun e Mesdheut

Grante të Vogla

Data e hapjes së thirrjes: E Hënë 28 Tetor 2019

Data për dorëzimin e propozimeve: E Mërkurë 18 Dhjetor 2019

Buxheti: Buxheti minimal i projektit është 5.000 dollarë amerikanë për projekt, ndërsa maksimumi është 30.000 dollarë amerikanë.

korniza kohore: Fillimi më i hershëm i pritshëm për aktivitetet e projekteve është 1.03.2020 dhe projektet duhet të përfundojnë jo më vonë se 30.05.2022.

Organizata BirdLife International, në rolin e saj si Ekipi Rajonal i Zbatimit (Regional Implementation Team - RIT) dhe në emër të Fondit të Partneritetit për Ekosisteme nën Rrezik Kritik (CEPF), bën thirrje për projekte-propozime në formë të Letrave të Synimit (Letters of Inquiry - LOI) për grante të vogla në hotspotin e Pellgut të Mesdheut. Mund të aplikojnë organizatat joqeveritare, organizatat komunitare, kompanitë private, universitetet dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile. U këshillojmë kërkuesve që të lexojnë me kujdes dhe në tërësi këtë thirrje, si edhe dokumentet përkatëse dhe të paraqesin një Letër Synimi ashtu siç përshkruhet.

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Fondi për ekosistemet nën rrezik kritik (Critical Ecosystem Partnership Fund - CEPF) është një iniciativë e përbashkët e Agjencisë Franceze të Zhvillimit, organizatës ndërkombëtare jo-qeveritare Conservation International, Bashkimit Evropian, GEF, Qeverisë së Japonisë, Fondacionit John D. dhe Catherine T. MacArthur dhe Bankës Botërore. Qëllimi kryesor i CEPF-së është të sigurojë përfshirjen e shoqërisë civile në ruajtjen e biodiversitetit. Financimi shtesë për grantet e vogla në nën-rajonin ballkanik është mundësuar nga Fondacioni MAVA.

Pellgu i Mesdheut është rajoni i dytë më i madh në botë që përcaktohet si "hotspot" i biodiversitetit dhe më i madhi nga të pesë rajonet që ndodhen në zonën klimatike mesdhetare. Investimet e CEPF-së në Mesdhe janë konceptuar si një proces pjesëmarrës që përfshin

bashkëpunimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile, donatorëve dhe shërbimeve qeveritare në tërë rajonin. Rezultati i këtij procesi është Strategjia e Investimeve (2017-2022), e cila është përfshirë në dokumentin ombrellë "Profili i ekosistemit", të disponueshëm këtu. Ky dokument përfshin një seri udhëzimesh strategjike, të ndara në prioritete të investimit, të cilat përcaktojnë llojet e veprimtarisë dhe kushtet për financim nga CEPF.

PLOTËSIMI I KUSHTEVE

Organizatat joqeveritare, shoqatat e qytetarëve, universitetet dhe ndërmarrjet private mund të aplikojnë për fonde. Individët nuk mund të aplikojnë drejtpërdrejt, por vetëm në bashkëpunim me organizata qytetare.

Organizatat duhet të kenë llogarinë e vet bankare dhe, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, ato duhet të kenë një autorizim për të marrë kontribute bamirësie.

Kompanitë ose institucionet e themeluara nga ana e qeverisë plotësojnë kushtet e financimit vetëm në qoftë se mund të provojnë që ndërmarrja ose institucioni:

- Ka një strukturë ligjore të pavarur nga cilado agjenci apo organ qeveritar;
- Ka autorizim për të kërkuar dhe marrë fonde private; dhe
- Mund të lëshojë kërkesa për imunitet sovran.

Grantet nuk mund të përdoren për:

- blerjen e tokës, zhvendosjen e pavullnetshme të njerëzve ose aktivitete që mund të ndikojnë negativisht në burimet fizike dhe kulturore, duke përfshirë ato që janë të rëndësishme për komunitetet lokale.
- aktivitete që mund të kenë një ndikim negativ mbi kombet indigjene ose aktivitete që nuk gëzojnë mbështetjen e gjerë të komuniteteve të tilla.
- zhvendosjen ose ndryshimin e ndonjë trashëgimie kulturore (duke përfshirë zona me vlera arkeologjike, paleontologjike, historike, fetare ose natyrore unike). Aktivitetet e propozuara duhet të marrin parasysh të gjitha masat e tjera mbrojtëse dhe sociale, ashtu siç përshkruhen në cepf.net.

AKTIVITETE TË PRANUESHME

Kjo thirrje kufizohet në aktivitetet dhe lokacionet për plotësimin e aktiviteteve që përshkruhen më poshtë.

Do të merren parasysh **vetëm** kërkesat për projekte me drejtimet strategjike dhe në vendet e mëposhtme:

- **Drejtimi strategjik 2**: Menaxhimi i qëndrueshëm i pellgjeve lumore
- **Drejtimi strategjik 4**: Ruajtja e bimëve
- **Shtetet**: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore, Mali i Zi

Propozimet për projekte mund të lidhen vetëm me njërën nga të dyja drejtimet strategjike: Drejtimi strategjik 2 **ose** Drejtimi strategjik 4. Nëse doni të paraqitni kërkesa për të dyja drejtimet, duhet të aplikoni për dy projekte të ndryshme.

Propozimet për projekte duhet të bazohen në ruajtjen e biodiversitetit si një komponent thelbësor dhe duhet të tregojnë qartë efekte pozitive lidhur me statusin e ruajtjes së biodiversitetit.

Atëherë kur është e rëndësishme, nxitësit e projekteve inkurajohen të harmonizojnë propozimet e veta me nismat ekzistuese kombëtare ose rajonale. Sinergjitë me organizatat e tjera janë gjithashtu të pranueshme, duke mbajtur mend se organizata kërkuese duhet të jetë partneri kryesor dhe të paraqesë kërkesën, ndërsa rolet e partnerëve të projektit duhet të tregohen qartë në LOI.

Nxitësit e projekteve që nuk janë nga vende të pranueshme për financim nga ana e CEPF mund të aplikojnë për projekte në qoftë se aktivitetet e projektit synojnë nevojat e ruajtjes brenda ato vendeve që plotësojnë kërkesat e financimit të CEPF. Organizatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare të forta inkurajohen që të përfshijnë organizatat lokale ose komunitetet si partnerë të projekteve të tyre ose të shpjegojnë se si aktorët lokalë do të përfshihen në mënyrë aktive në implementimin e projektit

I) Drejtimi strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i pellgjeve lumore

Gati një e tretë e specieve nën rrezik kritik që gjenden në këtë hotspot biodiversiteti janë kafshë dhe bimë të ujërave të ëmbla. Ato ekzistojnë në një gamë të gjerë ekosistemesh me ujëra të ëmbla, duke përfshirë lumenj, liqene, sisteme shpellash karstike, rrjedha jetëshkurtra në shkretëtirë dhe moçale bregdetare. Nevoja për të siguruar ujë për bujqësinë dhe konsumin njerëzor është një nga arsyet më bindëse për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Megjithatë, ekosistemet e ujërave të ëmbla kanë një përfaqësim të dobët në rrjetet kombëtare të zonave të mbrojtura, nën presion nga përdorimi i tepërt dhe ndotja, ndërsa speciet që jetojnë atje vuajnë nga shfrytëzim dhe shqetësim i tepërt. Ndryshimet klimatike kanë të ngjarë të përkeqësojnë këto probleme.

Mjetet e CEPF-së do të përdoren për të përmirësuar njohuritë tona lidhur me lokacionet e rëndësishme për biodiversitetin e ujërave të ëmbla, duke e përdorur këtë si një mundësi për të ndërtuar kapacitete kërkimore dhe për të implementuar aktivitete për ruajtjen e organizmave të ujërave të ëmbla. Për më tepër, mjetet do të përqendrohen në veprimet që do të realizohen në lokacion, punën me aktorët lokalë dhe angazhimin me palë të ndryshëm nga sektori qeveritar dhe privat, me qëllim për të siguruar lidhshmërinë në tërë pellgun.

Ka pasur përmirësime domethënëse në identifikimin dhe përcaktimin e zonave kryesore të biodiversitetit të ujërave të ëmbla (KBA) në këtë hotspot, si edhe të specieve të rrezikuara që jetojnë atje. Janë identifikuar zona të shumta për menaxhimin e pellgjeve (CMZ), duke marrë parasysh lidhjen hidrologjike dhe kërcënimet përtej kufijve të KBA-së, me qëllim për të informuar

më mirë rreth veprimeve të menaxhimit. Disa KBA me ujëra të ëmbla janë identike me CMZ, ndërsa të KBA-të e tjera janë brenda CMZ. Në këtë moment, metoda më e efektshme për prioretizimin e ekosistemeve me ujëra të ëmbla është t'u jepet prioritet CMZ-eve. CMZ specifike janë identifikuar si prioritet për mbështetje nga ana e CEPF-së, me dy KBA shtesë me ujëra të ëmbla që gjenden jashtë këtyre zonave (Tabela 2).

CEPF kërkon propozime për projekte, të cilat

- **janë të lidhura me Drejtimin Strategjik 2 përmes një ose disa Prioriteteve të investimit** (Tabela 1).
- **përqendrohen në njërën ose disa nga CMZ-të dhe KBA-të që tregohen në Tabelën 2**
- **ilustrojnë qartë se si aktivitetet e projektit do të kontribuojnë në mirëqenien e specieve të rrezikuara**

Tabela 1: Drejtimi Strategjik 2 me prioritetet përkatëse të investimit

Drejtimi strategjik	Prioritetet e investimit
2: Mbështetja e menaxhimit të qëndrueshëm të pellgjeve lumore përmes metodave të integruara për ruajtjen e biodiversitetit të kërcënuar të ujërave të ëmbla.	2.1: Përmirësimi i bazës së njohurive mbi biodiversitetin e ujërave të ëmbla dhe rëndësinë e shërbimeve të ekosistemeve me ujëra të ëmbla.
	2.2: Marrja e masave për të zvogëluar kërcënimet dhe për të përmirësuar menaxhimin e lokacioneve të zgjedhura në pellgjet prioritare me ujëra të ëmbla, në bashkëpunim me palët lokale të interesuara.
	2.3: Angazhimi i sektorit publik, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë për të mbështetur praktikat e integruara të menaxhimit të pellgjeve lumore, të cilat zvogëlojnë kërcënimin për biodiversitetin në zonat prioritare të administrimit të pellgut CMZ.

Detaje mbi prioritetet e investimit në kuadër të Drejtimit Strategjik 2:

• **Prioriteti i Investimit 2.1.** *Përmirësimi i bazës së njohurive mbi biodiversitetin e ujërave të ëmbla dhe rëndësinë e shërbimeve të ekosistemeve me ujëra të ëmbla.*
Informacionet mbi shpërndarjen, popullsinë dhe statusin e kërcënimeve ndaj biodiversitetit të ujërave të ëmbla brenda CMZ-ve prioritare janë në shumë raste të papërshtatshme për identifikimin e zonave që kanë nevojat më të urgjente të ruajtjes ose si pikënisje për vlerësimin e përmirësimit. Për më tepër, vlerat biologjike, sociale dhe ekonomike të shërbimeve në ekosistemet e pellgjeve të paprekura janë praktikisht të panjohura dhe nuk merren parasysh në mënyrë të mjaftueshme nga vendimmarrësit. CEPF do të mbështesë mbledhjen e këtyre informacioneve si hapi i parë drejt ndërmarrjes së veprimeve mbrojtëse.

• **Prioritetet e investimit 2.2.** *Marrja e masave për të zvogëluar kërcënimet dhe për të përmirësuar menaxhimin e lokacioneve të zgjedhura në pellgjet prioritare me ujëra të ëmbla, në bashkëpunim me palët lokale të interesuara*. OShC-të që do të mbështeten me grantet nga CEPF do të jenë në mundësi, mbas gjase, të ndërmarrin masa mbrojtëse direkte në lokacione të caktuara, ku puna me menaxherët ose aktorët lokalë mund të ndryshojë sjelljen dhe të zvogëlojë ndikimin e kërcënimeve specifike.

• **Prioriteti i Investimit 2.3:** *Angazhimi i sektorit publik, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë për të mbështetur praktikat e integruara të administrimit të pellgjeve lumore, të cilat zvogëlojnë kërcënimin për biodiversitetin në zonat prioritare të administrimit të pellgut CMZ.*
Megjithëse, mënyra më e përshtatshme për të organizuar veprimin e drejtpërdrejtë të OShC-eve, është realizimi i aktiviteteve në lokacione qartë të përcaktuara, lidhja midis sistemeve të ujërave të ëmbla e bën shumë të mundur që do të ketë nevojë për veprime në nivel të pellgjeve, me qëllim për të adresuar çështjet e cilësisë, vëllimit dhe rrjedhjes së ujit, si edhe shqetësimet lidhur me habitatin. Kjo përfshin edhe ndikimin e aktorëve nga qeveria dhe/ose sektori privat që janë të implikuar ose kanë autoritet për të ndikuar në këto çështje.

Tabela 2: Zonat e pranueshme për financim përmes kësaj thirrjeje.

Shtet	Lloji i zonës	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës
Shqipëria	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Butrintit
Shqipëria, Maqedonia e Veriut	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Ohrit
Shqipëria, Mali i Zi	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës
Shqipëria, Mali i Zi	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Pellgu i ulët i lumit Bojana
Bosnja dhe Hercegovina	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Shkarkimi i Trebizatit, duke përfshirë fushën e Imotit
Bosnja dhe Hercegovina	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Fusha e Popit dhe Trebishnjica
Bosnja dhe Hercegovina	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Delta e Neretvës dhe burimet/liqenet e lidhura, duke përfshirë Hutovo Blato
Maqedonia e Veriut	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Pellgu ujëmbledhës i Liqenit Doiran
Mali i Zi	Zona e menaxhimit të pellgut ujëmblëdhës	Pellgu ujëmblëdhës përreth Nikshiqit
Bosnja dhe Hercegovina	Zona kryesore e Biodiversitetit	Fusha e Livnës dhe Liqeni Busko
Bosnja dhe Hercegovina	Zona kryesore e Biodiversitetit	Mostarsko Blato

Këtu keni qasje në hartën interaktive të hotspoteve. Përdorni ikonën në pjesën e sipërme të djathtë "Lista e shtresave", për të zgjedhur shtresën që ju nevojitet, p.sh. CMZ.

Figura 1 Harta e CMZ-eve në Shqipëri

Figura 2 Harta e CMZ-eve në Bosnjë dhe Hercegovinë

Figura 3. Harta e CMZ-eve në Malin e Zi

Figura 4. Harta e CMZ-eve në Maqedoninë e Veriut

II) Drejtimi strategjik 4: Ruajtja e bimëve

Hotspoti i Pellgut të Mesdheut përcaktohet kryesisht në bazë të pranisë së komuniteteve botanike unike, me një numër jashtëzakonisht të madh të bimëve endemike. Ky drejtim strategjik përqendrohet në ruajtjen e bimëve të rrezikuara, duke përfshirë përmirësimin e njohurive lidhur me shpërndarjen dhe statusin e kërcënimeve ndaj bimëve endemike mesdhetare.

Shpërndarja e kufizuar dhe nevojat specifike të habitatit të disa prej bimëve të rrezikuara mundëson ruajtjen e tyre efektive në nivel lokal nga ana e OShC-ve lokale me kapacitet të kufizuar, në bashkëpunim me menaxherët e zonave të mbrojtura ose pronarët lokalë të tokave. Përveç përkrahjes me masa ruajtëse direkte, projektet në kuadër të këtij drejtimi strategjik duhet të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e shkencëtarëve, konservatorëve dhe administratorëve në fushën e botanikës.

CEPF kërkon projekte të cilat

- përfshijnë **Drejtimin Strategjik 4 përmes njërit ose disa nga Prioritetet e Investimit të përmendura në Tabelën 3.**

- synojnë kryerjen e aktiviteteve në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut (më shumë se një shtet mund të përfshihen nga një propozim projekti)

- **Aktivitetet duhet të synojnë zona ose specie bimore që plotësojnë njërin ose disa nga kriteret e mëposhtme:**

    - Zonat me specie bimore nën kërcënim kritik - *Critically Endangered* (CR) sipas Listës Globale të Kuqe të IUCN - IUCN Global Red List

    - Zonat me specie bimore që nuk janë vlerësuar sipas kritereve të Listës Globale të Kuqe të IUCN, por do të kualifikoheshin për kriterin CR të kësaj liste, po të vlerësoheshin sipas kritereve dhe pragjeve të kërcënimit të përmbajtura në Listën Globale të Kuqe të IUCN - IUCN global Red List criteria.

    - Bimët endemike me vendndodhje të kufizuar - *Site restricted endemics* (SRE), të cilat përfshijnë:

        - Taksonët që gjenden vetëm në një lokacion (dhe askund tjetër në botë)

        - Shtrirja e pranisë (*Extent of occurence*) është më pak se 100 km2

        - Zona e shpërndarjes (*Area of occupancy*) është më pak se 10 km2

Do të mbështeten në mënyrë prioritare projektet:

- Për të cilat është demonstruar që po synojnë një ose më shumë specie prioritare ose u referohen nevojave prioritare për ruajtjen e bimëve.

- Për të cilat është demonstruar që përfshijnë aktivitete direkte lidhur me ruajtjen e popullsisë së bimëve endemike të rrezikuara.

- Të cilat përfshijnë, në rastet ku është e mundur, një komponent të rëndësishëm të ngritjes së kapaciteteve në fushën e ruajtjes së bimëve, për kontraktorët e projektit ose partnerët e tyre lokalë

- Të cilat mbulojnë ruajtjen e vendeve, që kanë nevojë të qartë për financim dhe ku vlerësohet që veprimtaria e ruajtjes do të ketë sukses.

Propozimet e projekteve që synojnë zonat e KBA-së të identifikuara në Profilin e Ekosistemit do të prioretizohen në varësi të vlerës së njohur të biodiversitetit në lokacion. Nëse aktivitetet e ruajtjes janë planifikuar jashtë KBA-së, ju lutemi të ofroni koordinatat gjeografike, si edhe informacion shtesë (p.sh. pronësia, menaxhimi, statusi i mbrojtjes, komunitetet lokale, kërcënimet etj.) lidhur me lokacionin në propozimin e projektit.

Nëse specia bimore nuk është vlerësuar nga IUCN dhe Lista Globale e Kuqe Global i IUCN, kërkuesi është në detyrë të shpjegojë në mënyrë të qartë dhe sistematike arsyen, për të cilën ai konsideron që kjo specie renditet në kategorinë e specieve nën rrezik kritik (CR) në pajtim me Listën Globale të Kuqe të IUCN (duke përdorur kriteret e IUCN) dhe kërkon kujdes të veçantë për ruajtjen e saj. Nëse kërkuesi propozon të punohet mbi një endemë lokale, ai duhet të arsyetojë që specia i plotëson kriteret e mësipërme. Arsyetimi mund të përfshijë referenca për punën e kaluar mbi specien në fjalë, si edhe detaje të habitatit ku paraqiten kërcënimet për këtë specie.

Tabela 3: Drejtimi Strategjik 4 me prioritetet përkatëse të investimit

Drejtimi strategjik	Prioritetet e investimit
4: Përforcimi i përfshirjes së shoqërisë civile në ruajtjen e bimëve nën rrezik kritik ose ngushtësisht endemike.	4.1: Përmirësimi i njohurive dhe aftësive për të mbështetur vlerësimin dhe planifikimin e ruajtjes së bimëve, si edhe krijimin e gjenerata të reja të ekspertëve të rinj për ruajtjen e bimëve.
	4.2: Mbështetje për të përfshirë ruajtjen e bimëve në procesin e administrimit të zonave të mbrojtura.
	4.3: Mbështetje për aktivitetet novatore që kanë për qëllim ruajtjen e popullsive të konsiderueshme të bimëve dhe punën e përbashkët me pronarët e tokave dhe kontrolluesit.

Detaje mbi prioritetet e investimit në kuadër të Drejtimit Strategjik 4:

Prioriteti i investimit 4.1: *Përmirësimi i njohurive dhe aftësive për të mbështetur vlerësimin dhe planifikimin e ruajtjes së bimëve, si edhe krijimin e gjenerata të reja të ekspertëve të rinj për ruajtjen e bimëve.*

Një nga sfidat për të vazhduar procesin e identifikimit të IPA-së, lidhur me vlerësimin e statusit të ruajtjes së bimëve dhe marrjen e masave për ruajtjen e tyre, është numri i kufizuar i njerëzve në rajon me aftësitë e kërkuara në fushën e botanikës. CEPF do të mbështesë projektet që kanë një element të fortë lidhur me zhvillimin e aftësive praktike në fushën e botanikës, duke përfshirë hulumtimin, mbrojtjen *in-situ* dhe, në disa raste, mbrojtjen *ex-situ*. Kjo përfshin punën me institucionet arsimore tradicionale (d.m.th. Universitetet, institutet kërkimore etj.), si edhe punën mbi përmirësimin e aftësive të grupeve të tjera me potencial për të kontribuar në ruajtjen e bimëve, duke përfshirë menaxherët e zonave të mbrojtura, anëtarët e shoqërive vullnetare dhe menaxherët e tokës.

Prioriteti i investimit 4.2: *Mbështetje për të përfshirë ruajtjen e bimëve në procesin e administrimit të zonave të mbrojtura.*

Popullsia e bimëve të rrezikuar ndodhet shpesh brenda zonave të mbrojtura, por janë akoma nën kërcënim sepse administrimi (ose mungesa e tij) nuk adreson nevojat e tyre specifike për ruajtje.

Bursierët e CEPF-së do të bashkëpunojnë me Menaxherët e zonave të mbrojtura për të identifikuar kërcënimet dhe zgjidhjet e mundshme dhe gjithashtu për të siguruar që veprime specifike për ruajtjen e bimëve janë të përfshira në planet e administrimit të zonave të mbrojtura.

Prioriteti i investimit 4.3: *Mbështetje për aktivitetet novatore që kanë për qëllim ruajtjen e popullsive të konsiderueshme të bimëve dhe punën e përbashkët me pronarët e tokave dhe kontrolluesit.*
Shumë popullsi të bimëve të rrezikuara mbijetojnë në peizazhe të menaxhuara jashtë zonave të mbrojtura dhe kërcënohen potencialisht nga ndryshimet e mundshme në përdorimin e tokës. Bursierët e CEPF-së do të bashkëpunojnë me përdoruesit dhe pronarët e tokave për të identifikuar kërcënimet dhe për të promovuar praktika të përmirësuara të menaxhimit me qëllim për të ruajtur popullsitë e bimëve të rralla.

PROCESI I PARAQITJES SË KËRKESAVE

Kërkesat mund të shkruhen në **anglisht, serbokroatisht** (**serbisht, kroatisht, boshnjakisht dhe gjuhën malazeze)** dhe shqip.

Të gjithë kërkuesit duhet të **përdorin formën standarde të Letrës së Synimit (LOI)** në gjuhën e zgjedhur:

- anglisht
- serbo-kroatisht
- shqip

Kërkuesit duhet të paraqesin kërkesën e projektit deri në datën e mbylljes së thirrjes në: CEPF-MED-RIT@birdlife.org.

Kërkuesit do të marrin një njoftim me të cilën konfirmohet që RIT ka marrë kërkesën e projektit.

Procesi i shqyrtimit të kërkesave do të zgjasë përafërsisht 8 javë. Komisioni për shqyrtimin e propozimeve të projektit do të zgjedhë propozimet më cilësore, të cilat plotësojnë kërkesat e seksioneve 5 dhe 6. Të gjithë kërkuesit do të marrin një përgjigje lidhur me rezultatin e procesit të vlerësimit të kryer nga RIT.

Në qoftë se projektet e tyre janë zgjedhur, kërkuesit do të ftohen që të përpunojnë më tej propozimet e tyre, duke ofruar një buxhet më të detajuar dhe një matricë logjike. Projektet e miratuara përfundimisht do të marrin një grant të vogël dhe një kontratë midis BirdLife International, si RIT për Hotspotin e Mesdheut, dhe kërkuesit (fituesit të grantit). Grantet do të paguhen në dollarë amerikanë dhe kontratat do të hartohen në anglisht.

DOKUMENTACIONI I REKOMANDUAR

Ne inkurajojmë të gjithë kërkuesit që të rishikojnë me shumë kujdes Strategjinë e Investimeve të CEPF-së në Pellgun e Mesdheut, e cila ofron më shumë detaje lidhur me llojet e mundshme te aktiviteteve që financohen nga CEPF në kuadër të secilit Prioriteti të Investimit.

- Profili i Ekosistemit - Ecosystem Profile: anglisht
- Profili i ekosistemit - Përmbledhje teknike - *Ecosystem Profile - Technical Summary*: anglisht, arabisht, frëngjisht
- Harta e hotspoteve të Pellgut të Mesdheut mund të gjendet këtu

CEPF është e angazhuar për të përfshirë çështjet e barazisë gjinore në portofolin e saj. Për këtë arsye, i inkurajojmë kërkuesit që të konceptojnë dhe hartojnë propozimin e projektit, duke marrë parasysh çështjen e barazisë gjinore në kuadër të implementimit të rezultateve të projektit. CEPF ka zhvilluar disa mjete që mund të ndihmojnë për të planifikuar, implementuar dhe vlerësuar projektet me ndërgjegjësim gjinor (CEPF Gender Toolkit), si edhe për të kuptuar atë që kërkohet nga një propozim projekti (CEPF Gender Fact Sheet). Vizitoni faqen ueb të "CEPF and Gender webpage" që të mësoni më shumë rreth mënyrës se si CEPF adreson çështjet gjinore në projektet që i mbështet. Udhëzimet në shqip janë në dispozicion më poshtë. "

Ndihmë dhe burime të tjera:

- Plotësimi i kushteve dhe mënyra për të paraqitur kërkesën - Eligibility and How To Apply
- Pyetje të shpeshta - Frequently Asked Questions
- Masat mbrojtëse - Safeguard Policies
- 12 këshilla për të siguruar miratimin e projektit tuaj - 12 Tips for Getting Your Grant Idea Funded
- Baza e të dhënave të projekteve CEPF - CEPF Projects database

DETAJET E KONTAKTIT

Pyetjet ose sugjerimet, si edhe pyetjet lidhur me idetë e projektit dhe plotësimin e kushteve mund të diskutohen me anëtarët e RIT para paraqitjes së kërkesës.

- Milica Mišković, koordinatore për Grante të Vogla - Ballkan; milica.miskovic@pticesrbije.rs, tel: +381 213023361.
- Granit Gashi, Asistent për Grante të Vogla – Shqipëri; granit.gashi@pticesrbije.rs , tel: +383 49433395

Për pyetje të përgjithshme lidhur me programin CEPF Mediterranean Basin Hotspot, ju lutemi kontaktoni:

- Salwa Elhalwani, Small Grant Manager; Salwa.Elhalawani@birdlife.org
  ose vizitoni faqen ueb www.birdlife.org/cepf-med